



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:139402

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05431582

ARJ.nr.10/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Nenad Lazić anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në çështjen juridike sipas padisë në konfliktin administrativ të paditëses, F. J nga Gj., të cilën me autorizim e përfaqëson, Sylejman Klinaku, avokat nga Prishtina kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (KPMSHCK) me seli në P., me bazë juridike anulim vendimi me nr.A.02/245/2016 të datës 18.04.2023, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të të njëjtit, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditëses, paraqitur përmes të autorizuarit të saj, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.965/2023 të datës 15.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 29 shkurt 2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësja F.J, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.965/2023 të datës 15.12.2023.

II. Anulohen aktvendimi i Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative AA.nr.965/2023 të datës 15.12.2023, dhe aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1173/2023, i datës 08.11.2023, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.965/2023 të datës 15.12.2023, **REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e paditëses - propozueses, F.J nga Gj., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1173/2023, i datës 08.11.2023, **VËRTETOHET**.

Kundër aktvendimit të lartë cekur të Gjykatës Apelit, paditësja përmes të autorizuarit të saj, në afat ligjor në Gjykatën Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor,

me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të : I. Aprovohet në tërësi kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, dhe II. Aprovohet kërkesëpadija e paditëses si e bazuar në ligj apo çështja të kthehet në rigjykim ose të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.nr.965/2023 të datës 15.12.2023 dhe ai i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1173/2018 datë 08.11.2023, duke caktuar masën e sigurisë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës A.nr.0/245/2016 datë 18.04.2023 deri në vendosjen meritore në lidhje me kërkesëpadinë e paditëses.

Gjykata Supreme në përputhje me nenin 53 të LKA-së mbajti seancën, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesë, ekzaminoi aktvendimin e kontestuar të gjykatës së shkallës së dytë dhe atë të shkallës së parë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me aktvendimin A.nr.1173/23 të datës 08.11.2023, (nr. lëndës 2023:139402), të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, refuzohet propozimi i paditëses - propozueses M.Gj, të cilët sipas autorizimit e përfaqëson Mehdi Geci avokat, me adresë në Zonën Qendër në rrugën “Sylejman Vokshi”, 0-3, Hyrja 1 nr.5-Prishtinë, me të cilin ka kërkuar që të anulohet vendimit me nr.A.280/2023 i dt.30.03.2023, i të paditurit/kundërpropozuesit, derisa të merret vendimi i plotfuqishëm gjyqësor sipas padisë së ushtruar në Gjykatë, lidhur me këtë çështje, si i pabazuar.

Në arsyetim të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë ndër të tjera theksohet se: Paditësja-propozuesja M.Gj, të cilët sipas autorizimit e përfaqëson Mehdi Geci avokat nga Prishtina, me datë 14.06.2023 ka paraqitur padi në këtë Gjykatë duke kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimit me nr.A.280/2023 i dt.30.03.2023, përkatësisht shtyrjen e ekzekutimit të së njëjtës, deri në një vendim përfundimtar nga ana e gjykatës.

Tutje theksohet se: Gjykata pas shqyrtimit të propozimit të paditëses për pezullim të ekzekutimit të vendimit të kontestuar, gjeti se ky propozim nuk përmban asnjë fakt të bazuar në ndonjë provë me të cilin do t'i bënte të besueshme pretendimet e tij, se si pezullimi i vendimit të goditur me padi, të njëjtës do ti sillte dëm, se dëmi vështirë do të riparohet dhe se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, kusht ky ligjor i cili duhet të provohet nga paditësja, që pastaj kjo gjykatë të mund të vendos për pezullim të ekzekutimit të vendimit.

Në këtë çështje shkalla e parë nxjerrë po ashtu vendim të njëjtë me datë dhe numër të njëjtë, pa SMIL me të cilin në dispozitiv e refuzon propozimin e paditëses F. J., me të cilën ka kërkuar të anulohet vendimi me nr. A/245/2016 i dt. 18.04.2023 i të paditurit deri sa të merret vendim i plotfuqishëm gjyqësor sipas padisë së ushtruar në gjykatë lidhur me këtë çështje si i pabazuar.

Gjykata e Apelit në procedurë ankimore me aktvendimin e kontestuar me kërkesë, AA.nr.965/2023 të datës 15.12.2023, duke vendosur si në kuptim të nenit 194, të LPK-së, (ligj i aplikueshëm në kuptim të nenit 63 të LKA-së), e refuzon ankesën e paditëses si të pa bazuar ndërsa aktvendimin e shkallës së parë, A.nr.1173/2023, i datës 08.11.2023, e vërteton.

Në arsyetim pasi bënë përshkrimin e gjendjes së vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të saj, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit në rastin konkret nga paditësja nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, ashtu si parashihet në nenin 22 të LKA-së. Pretendimet e paditëses në ankesë i refuzon si jo të qëndrueshme, të pa mjaftueshme, dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa, nga se edhe sipas kolegjit kërkesa tërësisht mbështet në fakte që kanë të bëjnë me çështjen kryesore për të cilën gjykata do të vendos në mënyrë meritore në procedurë të rregullt, por që tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrje e ekzekutimit të vendimit të kontestuar. Andaj konstaton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozita procedurale dhe materiale me refuzimin e kërkesës së paditëses për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur.

Gjykata Supreme tani për tani nuk mund ti pranojë si të drejta pikëpamjet e lartpërmendura të gjykatave të instancave më të ultë, sepse në aktgjykimet e tyre ato nuk i kanë paraqitur arsyet për faktet vendimtare, kurse arsyet e paraqitura janë të paqarta dhe kontradiktore dhe, në të njëjtën kohë, ka edhe kundërthënie ndërmjet arsyesimit të aktgjytimeve dhe dispozitivit dhe nuk janë në harmoninë e duhur logjike dhe juridike, ndërsa faktet vendimtare nuk janë vërtetuar dhe arsyetuar si duhet, për çka edhe është bërë vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike, si rezultat i së cilës është bërë edhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të parashikuara nga nenin 182 par.2 pika (n) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së. Kështu, në nenin 182 par.2 pika (n) të LPK-së parashikohet që shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit”*.

Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore qëndron në faktin se dispozitivi i aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetvete dhe me arsyet e aktvendimit, përkatësisht gjykata e shkallës së dytë në dispozitivin e saj refuzon si të pabazuar ankesën e paditëses – parashtrueses së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit gjyqësor F. J., nga Gj., dhe vërteton aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa në arsyetim i referohet aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë me të cilin aktvendim refuzohet kërkesa e propozueses M. Gj., e cila nuk është palë paditëse dhe as parashtruese e kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit

gjyqësor në këtë procedurë të konfliktit administrativ por është F.J.. Përveç dispozitivit edhe arsyetimi i aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë A nr. 1173/23 nr. i lëndës me Smil 2023:139402 i referohet kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të parashtruar nga pala M.Gj., çka nënkupton se vërtetimi i këtij aktvendimi në drejtim të parashtrueses së kërkesës F.J., nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, për deri sa në këtë çështje gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë edhe aktvendimin tjetër me numër të njëjtë pa nr. të lëndës me SMIL me përmbajtje të tjetër që i referohet propozimit të paditëses ashtu si u thksua si më lartë.

Në këtë rast Gjykata Supreme e Kosovës, ka mjaftuar me shkeljet e theksuara më lartë dhe nuk është lidhur në pretendimet e tjera të paraqitura sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, për aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me çka mbi bazën e shkeljeve të konstatuara aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe të parë u dashtë që të anulohen dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë në rishqyrtim, udhëzohet që ti mënjanojë të metat e përmendura më lartë dhe të vërtetojë faktet dhe provat që lidhen me pretendimet e paraqitura nga parashtruesja - paditësja F.J., dhe varësisht nga gjendja faktike që do të vërtetohet, me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, të vendos drejtë dhe në mbështetje të ligjit mbi në kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Në fund, udhëzohet gjykata e shkallës së parë, që me rastin e përpilimit të aktgjykimit, t'i ketë parasysh kërkesat ligjore që rrjedhin nga dispozita e nenit 160 të LPK-së (*të hartoj dispozitivin dhe arsyetimin e aktgjykimit në përputhje me paragraf 2,3, 4 dhe 5 të nenit 160 të LPK-së*), i aplikueshëm në bazë të nenit 63 të LKA-së, ashtu që pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse dhe vlerësimit të arsyetuar detajisht të provave materiale, të vendosë për kërkesën e palës paditëse, në bazë të ligjit.

Nga theksimet si më lartë me që aktvendimet e kontestuar janë të përfshirë me shkeljet e pretenduara si në kërkesë dhe si në kuptim të dispozitave të cekura si më lartë të LKA, të njëjtit anulohen dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata e shkallës së parë obligohet që në ri procedurë ti mënjanojë mangësitë e cekura të vlerësoj provat dhe faktet e paraqitura me padi, dhe kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe pas administrimit të provave të nevojshme të nxjerrë vendim të drejtë dhe ligjor duke ju referuar pretendimeve dhe parashtrueses së kërkesës – paditëses F.J.. Gjykatat e instancave më të ulëta në ri procedurë duhet ti kushtojnë kujdes të veçantë të gjeturave dhe vërejtjeve të theksuara si më lartë në këtë aktvendim.

Nga sa u parashtrua si më lartë dhe në bazë të nenit 54, paragrafi 2 dhe 3, të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ nr.10/2024, me datë 29 shkurt 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani